

## NË EMER TE POPULLIT

**Gjykata Themelore ne Gjilan, Departamenti per Krime te Rënda**, duke vendosur sipas kryetarit te trupit gjykues Naser Maliqi, ne qështjen penale te te pandehurit I. K.nga fsh. K., K. K., per shkak te veprave penale mbajtja ne pronesi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 paragrafi 1 te KPRK-se, dhe veprës penale importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materjeve plasëse nga neni 372 paragrafi 1 të KPRK – së. të cilin sipas autorizimit e mbron av. S. R. nga Gj., sipas aktakuzes se Prokurorise Themelore ne Gjilan, Departamenti per Krimet e Renda, PP. I.nr.95/16, e dt. 29.04.2016, e pas mbajtjes e shqyrtimit fillestar me dt. 29.09.2016, shpalle:

## AKTGJYKIM

**Ndaj te pandehurit I. K.** nga nga babai S. dhe e ema H., ne lindur K., i lindur me dt. ..., në fsh. K., K. K., ku edhe tani jeton, ka te kryer të shkollës fillore, i martuar, baba i ... fëmijëve, i gjendjes së varfër ekonomike shqiptar, shtetas i Republikës së Kosoves, më parë nuk ka qenë i dënur e as nën hetime.

## ËSHTË FAJTORË

### SEPSE

#### I.

Në kohë të vërtetuar më parë e gjerë me date: ... .2016, I pandehuri në shtëpinë e tij në fsh. K., Komuna e K., pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, ka mbajtur në pronësi armën e zjarrtë dhe atë një revole të markës “...” me numër serik ... , ... Karikator të zbratur.

**-Me që rast ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK – së.**

#### II.

Më ... 2016, rreth orës ..., në K., mbrapa marketit “...” i pandehuri me veprimet e tij në mënyrë alternative në mënyrë të kundërligjshme me vetëdije jashtë dispozitave ligjore pa poseduar leje të caktuar të organit kompetent dhe në kundërshtim me Ligjin për armët të në Kosovë, ia shet armën e zjarrtë dhe atë një revole të markës “...”, me numër serik ..., dhe me ... fishekë të miturit E.

R. nga K. në shumë prej 120 euro, të cilën revole i mituri ia ka dhënë të miturit E. I..

**-Me që rast ka kryer veprë penale importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetsimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materjeve plasëse nga neni 372 paragrafi 1 të KPRK – së.**

-Andaj, në bazë të nenit 4, 7, 41, 42, 43, 45, 46, 47, 69,80 të KPRK, dhe nenit 233, 365 dhe 450 të KPPRK, se

## **KONSTATON**

**- Për veprën penale nën dispozitivin I.** e gjykon me dënim gjobë në shumë prej 300 ( treqinde) euro,

**- Për veprën penale nën disp**

**-ozitivin II.** e gjykon me dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesqind) euro, si dhe dënim me burg në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetdhjet) ditëve, I cili dënim nuk do të egzekutohet, me kusht që brenda një viti nuk kryen veprë tjetër penale.

## **E GJYKON**

**Me dënim unik me gjobe në shumë prej 800,00 euro (tetqind),** të cilin është I detyruar ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmeris së këtij aktgjykimi, në të kundërtën I njëjti mund të zëvendsohet me dënim me burg, duke llogaritur për çdo 20 euro nga një ditë burg, si dhe dënim me burg në kohëzgjatje prej 180 ditësh, I cili dënim **nuk do të egzekutohet me kusht** që në afat prej 1 viti mos të kryej veprë tjetër penale.

**Konfiskohet** arma e llojit: revole "...", me numër serik ..., dhe ... karikator i zbrazur, konform nenit 374 paragrafi 3 të KPRK-së.

## **ARSYETIM**

**Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rëndë,** më dt.29.04.2016, ka ngritur aktakuzën PP.I. nr. 95/2016, ndaj të akuzuarit I. K., për shkak të veprave penale, mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374.paragrafi 1. të KPRK-së dhe veprës penale importi eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetsimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materjeve plasëse nga neni 372 paragrafi 1 të KPRK -së dhe ka kërkuar që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet me dënim meritore sipas ligjit.

Kryetari I trupit gjykues, me dt. 29.09.2016, ka mbajtur seancen fillestare, ne te cilen I pandehuri I. K.dhe mbrojtësi I tij Av. S. R. kanë qëndruar në tërsi pranë marrveshjes së arritur me PTH-DKR në Gjilan , të datës 13.07.2016,me,nr.PP.I.nr.95/2016.

Prokurori I shtetit Agron Uka ka mbetur në tërsi pranë marrveshjes me shkrim në PTH-Gjilan Prokurorin Themelore në Gjilan, PP.I 95/2016 e datës 13.07.2016,meqense marveshja është bërë me autorizim të prokurorit të PTH në Gjilan, ashtu që janë marr veshë që të pandehurit ti shqiptohet një denim me gjobë në shumë prej 300 euro, për shkak të vepërs penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së. dhe për veprën penale importimi, eksportimi, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetsimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materjeve plasëse nga neni 372 paragrafi. 1 të KPRK – së ti shqiptohet denim me gjobë prej 500 euro, si dhe denim me burg prej 180 ditësh I cili denim nuk do të egzekutohet nese I akuzuari nuk kryen veper penal ne afat prej një viti, po ashtu ti shqiptohet edhe dënimi plotësues, konfiskimi I armës së zjarrtë dhe karikatorit I zbrazur.

Gjykata ka aprovuar këtë marveshje mbi pranimin e fajsisë, për shkak se është në përputhje me nenin 233 të KPPK-së me provat në shkresat e lëndës dhe ka vendos si në dispozitiv të këti aktgjykimi Sa i përket armës së zjarrtë ajo është konfiskuar, konform nenit 374 paragrafi,3tëKPRK-së.

I pandehuri është detyruar që ksaj gjykate ti paguaj paushallin prej 20 euro ndërsa shpenzimet e procedures sipas llogaris përfundimtare të kësajgjykate.

**GJYKATA THEMELORE NE GJILAN**  
**DEPARTAMENTI PER KRIME TE RENDA**  
**Me dt. 29.09 .2016**

**Sek. Jurdike,**  
**Zahide Rexhepi**

**Kryetari I trupit:**  
**Naser Maliqi**

**KSHILLA JURIDIKE:** kunder ketij aktgjykimi, palet e paknaqura munde te ushtrojne ankese ne afat prej 15 ditesh, nga dita e marrjes ne Gjykatën e Apelit te Kosoves ne Prishtine, e nepermes kesaj Gjykate.